
RECENSIONE

LEDIA DUSHKU: KUR HISTORIA NDAU DY POPUJ FQINJ. SHQIPËRIA DHE GREQIA (1912-1914), Tiranë: Kristalina-KH, 2012, 379 f.

Monografia e dr. Ledia Dushkut “Kur historia ndau dy popuj fqinj. Shqipëria dhe Greqia (1912-1914)”, ndonëse trajton një periudhë e tematikë jo pak të njohur e trajtuar nga historiografia deri më sot, na vjen si një befasi e këndshme me plot risi, detaje, argumente, analiza logjike e elegancë në paraqitje.

Studiuesja Ledia Dushku ka guxuar dhe ja ka dalë me sukses të na ofrojë një monografi me parametra cilësore, e cila është sprova, që e fut në radhën e historianëve të formuar, skrupulozë e me kërkesa ndaj vetes.

Natyrisht monografia është edhe ndër arritjet e Institutit të Historisë, që erdhi në kohën e duhur duke kompletuar kolanën e botimeve që Instituti kishte programuar të botonte në kuadër të 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë.

Konstatoj me kënaqësi, duke parë çka është arritur në këtë monografi, se koha e shpenzuar për të mbërritur te ky finalizim, nuk është kohë e humbur, sepse ka shërbyer për të na ofruar një produkt cilësor. Njëherësh ka ndikuar në formatimin e autores, e cila me angazhimet e ndërkohshme me sukses në disa projekte, ka arritur pjekurinë e një studiueseje serioze e pasionante, tipare këto të domosdoshme në punën e një historianeje që synon kuota të larta.

Monografia “Kur historia ndau dy popuj fqinj. Shqipëria dhe Greqia (1912-1914)” është hartuar me një bazë të mirë bibliografike e arkivore, për kushtet në të cilat ka punuar autorja, duke minimizuar dukshëm pasojat e mbylljes së fqinjit tonë jugor, që, për hir të politikës, ende është vend problematik për studiuesit shqiptarë.

Fillimisht në monografi jepet një informacion që i paraprin tematikës në kronologjinë e viteve 1912-1914. Autorja sjell të dhëna interesante rreth përfrimeve dhe ndasive shqiptaro-greke në periudhën e gjallërimit të lëvizjeve kombëtare në Ballkanin e shek.XIX. Është bindës vlerësimi i saj se, edhe pse ekzistonin faktorë objektivë për afrimin shqiptaro-grek, boshti i politikës së jashtme të Greqisë, synimet dhe veprimet për ekspansion në Shqipërinë e Jugut krijuan dasitë, që nuk do të mbylleshin, pavarësisht predispozicionit të përsëritur të përfaqësuesve të shquar të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

Në këtë kuadër bëhet fjalë për tentativat e Abdyl Frashërit për bashkëpunim në vitet 1877-1878, të Ismail Qemal Vlorës në vitet 1900-1909, për qëndrimin e dyzuar të politikës greke ndaj kryengritjeve shqiptare të viteve 1910, 1911 etj.

E gjithë kjo prehistori e raporteve dypalëshe do të vijojë të trajtohet me një vëmendje e analizë kapilare të zhvillimeve të viteve 1912-1914.

Ngjarjeve të vitit 1912, parapërgatitjeve të shqiptarëve për kryengritjen e re antiosmane dhe mandej të dhënave rreth zhvillimit të saj, si edhe përpjekjeve të shqiptarëve për të siguruar mbështetje te fqinjët e tyre, znj. Dushku i ka shtuar faktet dhe analizat për qëndrimin e Greqisë. Në mënyrë të padyshimtë ato dëshmojnë se ndonëse vijonin të ekzistonin objektivistat premisat për bashkëpunim me interes të ndërsjelltë, qarqet drejtuese të Athinës, për shkak të mbështetjes në platformën e hershme ekspansioniste të Megali Idesë, ndërmorën veprime dhe u bënë palë me ato shtete që synonin të pengonin krijimin e shtetit shqiptar dhe aneksimin e trevave shqiptare. Në monografi në këtë kuadër, trajtohet ftohtë, me elegancë dhe skrupulozitet shkencor, mbështetja e Athinës për planin antishqiptar të Serbisë, futja e trupave greke në viset shqiptare, shfaqja e pretendimeve ndaj këtyre viseve në Londër, përpjekjet për të rrëzuar qeverinë e përkohshme të Vlorës dhe për të penguar stabilitetin në Shqipëri etj.

Një vëmendje të veçantë, përmes paraqitjes së dokumentacionit më përfaqësues si edhe përmes analizës së saktë, autorja i kushton përpjekjeve të diplomacisë greke për të ndikuar në vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër e mandej pranë Komisionit Ndërkombëtar për caktimin e kufirit jugor të Shqipërisë. Duke operuar me dokumente të panjohura, ose që më herët janë anashkaluar pa u kushtuar vëmendjen e duhur, znj. Dushku ka dhënë një tablo shumë realiste për zhvillimet intensive të vitit 1913 dhe fillimvitit 1914. Kombinimi i përpjekjeve diplomatike dhe ushtarake të Greqisë, në përpjekjet për të thyer faktorin shqiptar dhe për të gjetur hapësira në qëndrimet me diferenca të Fuqive të Mëdha për çështjet shqiptare e rajonale, japin me vërtetësi situatën, hap pas hapi, gjatë gjithë periudhës në fjalë.

Me shumë realizëm paraqitet nga autorja edhe qëndrimi i Greqisë në gjashtë muajt e qeverisjes së Princ Vidit. Dilemat e diplomacisë së Athinës ndaj kandidaturës së Vilhelm Vidit, nxitja dhe përdorimi prej saj i “Lëvizjes Vorioepirote”, janë ndërthurje shumë interesante e të trajtuara me argumente të pakundërshtueshme. Hapat e qeverisë shqiptare për të vendosur rendin në jug, roli i Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, i holandezit Tomson, ndërthurja e ngjarjeve në fjalë me ato të ndodhura në Shqipërinë e Mesme, gjithashtu kanë pa dyshim origjinalitetin jo vetëm stilistik por edhe përmbajtësor të studimit. Situatën e pazakontë në Shqipërinë e kësaj kohe, që I. Kadare e shpreh artistikisht te “Viti i mbrapshtë”, monografia e znj. Dushku e paraqet përmes një tabloje rigorozisht shkencore.

Do të përfundoja duke nënvizuar se mënyra e të shkruarit në monografinë “Kur historia ndau dy popuj fqinj. Shqipëria dhe Greqia (1912-1914)” është në parametrat më të mirë redaktorialë dhe frazat rrjedhin me mjaft elokuencë. Po t'i shtojmë këtij konstatimi strukturën mjaft të zgjedhur e funksionale të

monografisë, padyshim fryt i këmbënguljes së vazhdueshme të autores për të përmirësuar çdo ditë e deri në çastet e fundit, gjithçka, mandej të shtojmë se argumentet dhe konkluzionet janë të qëlluara, se është pasqyruar siç dihet bibliografia e shfrytëzuar dhe monografia është pajisur me një tregues emrash të evidentuar me kujdes, atëherë është e kuptueshme pse duhet ta përgëzojmë autoren.

Autenticiteti i monografisë, që spikat veçanërisht në kap.II, III, IV, V, VI, kur trajtohet “Kryengritja shqiptare antiosmane e vitit 1912 dhe Greqia”, “Shqipëria dhe Greqia në rrjedhjet e Luftërave Ballkanike”, “Përpjekjet e Greqisë për të aneksuar Shqipërinë e Jugut”, “Marrëdhëniet shqiptaro-greke, mars-prill 1911”, “Marrëdhëniet shqiptaro-greke pas reagimit të Fuqive të Mëdha”, duke i dhënë vlerë të veçantë studimit, e fut këtë botim midis arritjeve të shëndetshme të historiografisë sonë të viteve të fundit.

Marenglen VERLI

